

# ALARM 16

## PUSHTET GËNJESHTARË, TELLALLË GËNJESHTARË

Qendra për komunikime e VMRO-DPMNE-së gënjeu kur më 3 korrik dërgoi deklaratë për shtyp tek mediet që fillon me gënjeshtër: "Tribuna e sotme e LSDM-së është harxhim koti e parave sorosoide nga ana e Milçin". Gënjeshtera meriton një Gebells. Ajo është aq transparente sa që nuk është madje as në [www.vmro-dpmne.org.mk](http://www.vmro-dpmne.org.mk). Megjithatë e kemi si kopje.

Pas kësaj gënjeshtre vijoi përdorimi masiv i taktikës propaganduese GËNJESHTRA NË RADHË, e njohur nga përsëritja e titujve dhe shpejtësia e kopjimit.

Gënjeu [www.denesen.mk](http://www.denesen.mk) kur më 8 korrik më 14.23 orën publikuan gënjeshtërën "Takimi sekret për nxitjen e tensioneve?!". Për më pak se tre orë e gjysmë, gënjeshtera ishte e përsëritur pothuaj se me titullin e njëjtë në [www.kurir.mk](http://www.kurir.mk) në orën 14.31, [www.puls24.mk](http://www.puls24.mk) në orën 14.40, [www.netpress.com.mk](http://www.netpress.com.mk) në orën 14.42, [www.republika.mk](http://www.republika.mk) në orën 14.45, [www.evesti.mk](http://www.evesti.mk) në orën 15.09, [www.press24.mk](http://www.press24.mk) në orën 15.19, [www.maxim.mk](http://www.maxim.mk) në orën 15.45, [www.mkd-news.com](http://www.mkd-news.com) në orën 16.01, [www.sitel.com.mk](http://www.sitel.com.mk) në orën 16.37, [www.alfa.mk](http://www.alfa.mk) në orën 18.03, [www.think.mk](http://www.think.mk). Kurrë, as atëherë, as më herët por as më tutje nuk është zhvilluar ndonjë takim sekret ose publik të Kabranov, Milçin ose Fërçkoski, madje asnjë anëtarë të udhëheqjes së LSDM-së.

Gënjeu [www.kurir.mk](http://www.kurir.mk) kur më 9 korrik më 14.41 orën publikuan dezinformatën e intonuar policore: "Për momentin Milçin pranoi që kontrollon 7 medie!". Milçin nuk pa pasur çfarë të pranojë, ai përsëriti informacionin publik që Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni mbështet financiarisht 7 medie. Megjithatë, gënjeshtera, pothuaj se me titullin e njëjtë, për tre orë ishte përsëritur nga 9 medie tellallë: [www.press24.mk](http://www.press24.mk) në orën 14.50, [www.vistina.mk](http://www.vistina.mk) në orën 14.57, [www.netpress.com.mk](http://www.netpress.com.mk) në orën 14.58, [www.republika.mk](http://www.republika.mk) në orën 15.06, [www.denesen.mk](http://www.denesen.mk) në orën 15.11, [www.evesti.mk](http://www.evesti.mk) në orën 15.20, [www.maxim.mk](http://www.maxim.mk) në orën 15.31, [www.sitel.mk](http://www.sitel.mk) në orën 16.35, [www.kanal5.com.mk](http://www.kanal5.com.mk) në orën 17.50. Ditën e ardhshme, më 10 korrik, 8 medie tellallë të udhëhequr nga [www.kurir.mk](http://www.kurir.mk) e tejkaluan veten dhe për vetëm 65 minuta vendosën një gënjeshtër të zgjeruar dhe përmirësuar me titullin e njëjtë: "Milçin thotë që nuk ka pasur demokraci, ndërsa pranon që kontrollon për momentin 7 medie". Në titullin i saktë është vetëm numri.

Gënjeu [www.republika.mk](http://www.republika.mk) kur më 16 gusht publikoi një shkresë me titull mashtrues, kinse një pyetje: "A kanë vizituar Milçin, Geroski dhe Kabranov Zaevin në Greqi?". Nuk janë takuar Milçin, Geroski dhe Kabranov në Greqi, madje as nuk kanë vizituar Zaevin në Greqi.

Gënjyen [www.republika.mk](http://www.republika.mk), [www.maxim.mk](http://www.maxim.mk) dhe [www.press24.mk](http://www.press24.mk) kur më 3 shtator deklaruan që portali Libertas është medie e financuar nga Soros. Për shkak të mungesës së financave në vitin 2014, portali Libertas nuk është grantist i Fondacionit.

Kanë gënjyer madje 9 medie tellallë kur më 6 shtator kanë parashtruar pyetjen: "LSDM-ja do të organizojë drekë në Tri Krushi, por nuk tregon se kush do të paguajë?" që të mund të përgjigjen pyetjes "...ose ndoshta Fondacioni Shoqëri e Hapur Maqedoni - e njohur me emrin Soros me të cilën udhëheq Vlladimir Milçin?". Përgjigja e vërtetë e kësaj pyetje mashtruese është që Fondacioni Shoqëri e hapur - Maqedoni nuk ka paguar kurrë dhe nuk do të paguajë dreka partiake, madje as mëngjese.

Gënjyen [www.kurir.mk](http://www.kurir.mk), [www.maxim.mk](http://www.maxim.mk), [www.evesti.mk](http://www.evesti.mk), [www.republika.mk](http://www.republika.mk), [www.lider.mk](http://www.lider.mk), [www.denesen.mk](http://www.denesen.mk), [www.vecer.mk](http://www.vecer.mk), [www.media.mk](http://www.media.mk), [www.zase.mk](http://www.zase.mk) dhe [www.puls24.mk](http://www.puls24.mk) kur më 7 dhe 8 shtator publikuan një dezinformatë që "portali Narden Gllas është një prej disa ueb faqeve të financuara nga Fondacioni Soros e Vlladimir Milçin". Jo, portali Naroden Gllas nuk ka qenë dhe nuk është i financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

Gjithashtu, kanë gënjyer [www.republika.mk](http://www.republika.mk) dhe [www.puls24.mk](http://www.puls24.mk) gjatë këtyre dy ditëve kur kanë përhapur dhe përmirësuar hajkën, që Vlladimir Milçinit i ngjitën Fejsbuk komentit e Mirjana Najçevskës.

Gënjeshttrat e një pas njëshme janë bërë një instrument i rregullt përdorimi në luftën propaganduese të Qendrës për Komunikime të VMRO-DPMNE-së. Në hajkën kundër gjithë atyre që e vlerësojnë në mënyrë kritike sundimin tetëvjeçar të partisë së Gruevskit përdoren kualifikimet më të zeza, gënjeshttrat më të ultë dhe fabrikohen mashtrime nga arsenali i propagandës naziste dhe staliniste. Autorët shumë shpesh mbeten të fshehur në të panjohurën. Të hollat buxhetore me të cilat financohet lufta propaganduese janë të mbuluar me shirit të fshehtësisë, por edhe shumat që prekin në opinion janë marramendëse.

Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni do të vazhdojë të mbështet mbajtjen e lirive minimale të nevojshme të medieve në Republikën e Maqedonisë dhe do të vazhdojë të informojë opinionin për mbështetjen e saj për mediet kritike, ngjashëm siç ka bërë nga formimi i saj në vjeshtën e vitit 1992. Për dallim nga pushteti gënjeshtar që vazhdimisht shmang të njoftojë qytetarët për mjetet buxhetore me të cilat mirëmban perandorinë e saj të medieve.



FOUNDATION  
OPEN SOCIETY  
MACEDONIA  
ФОНДАЦИЈА  
ОПШТЕСТВО  
МАКЕДОНИЈА